



Ftesë për ofertë

Titulli i ofertës: “Angazhim i Auditorit të Teknologjisë Informative (TI) me detyrë specifike”

Data e hapjes për ofertim: 16.04.2026

Data e mbylljes për ofertim: 30.04.2026

Agjencioni për financim në Kosovë - AFK fton auditorët e kualifikuar të Teknologjisë Informative (TI) që të paraqesin ofertat e tyre për realizimin e një angazhimi auditimi me detyrë specifike në Departamentin e TI-së.

Qëllimi i angazhimit:

- Vlerësimi i efektivitetit të proceseve të TI-së;
- Vlerësimi i sistemit të kontrollit të brendshëm në TI;
- Vlerësimi i përputhshmërisë me politikat e brendshme dhe kërkesat rregullative;
- Vlerësimi i qeverisjes dhe menaxhimit të rrezikut në TI;
- Identifikimi i rreziqeve në sistemet dhe proceset e TI-së;
- Ofrimi i rekomandimeve për përmirësim.

Fusha e auditimit përfshin:

- Qeverisjen e TI-së dhe strukturën organizative;
- Menaxhimin e rrezikut në TI;
- Operacionet dhe infrastrukturën e TI-së;
- Sigurinë e informacionit (në përputhje me ISO/IEC 27001);
- Vazhdimësinë e biznesit dhe rimëkëmbjen nga katastrofat (BCP/DRP);
- Menaxhimin dhe funksionimin e aplikacioneve;
- Përputhshmërinë me politikat dhe procedurat e brendshme;
- Përputhshmërinë me kërkesat rregullative për institucionet financiare.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Vlerëson funksionimin dhe efektivitetin e kontrolleve të TI-së;
- Analizon sistemet dhe proceset ekzistuese të TI-së;
- Identifikon rreziqet;
- Jep rekomandime konkrete për përmirësim;
- Përgatit dokumentacionin dhe raportet e auditimit;
- Bashkëpunon me menaxhmentin gjatë procesit të auditimit.

Auditimi duhet të kryhet në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit të TI-së, duke përfshirë praktikat e COBIT, ISO/IEC 27001 dhe standardet relevante të ISACA, si dhe kërkesat për sektorin financiar.

Rezultatet e pritshme:

- Plani dhe metodologjia e auditimit;
- Raporti paraprak (draft) me gjetje dhe rekomandime;
- Raporti final i auditimit (në gjuhën shqipe dhe angleze);
- Prezantimi i gjetjeve kryesore para menaxhmentit.

Afati për dorëzimin e raportit final: 29.01.2027.

Kriteret e kualifikimit:

- Certifikim në auditim të sistemeve të TI-së (p.sh. CISA ose certifikim i ngjashëm), me përparësi CISA;
- Së paku 2 vite përvojë në auditim të TI-së;
- Diplomë universitare në shkenca kompjuterike ose fusha të ngjashme;
- Njohuri të mira të gjuhës angleze;
- Përvoja në sektorin financiar (përparësi);

Dokumentet e kërkuara:

- Letër motivuese;
- CV;
- Referenca profesionale relevante;
- Dëshmi për kualifikimet dhe certifikimet (të skanuara).

Oferta duhet të përfshijë:

- Propozimin teknik (metodologjia, qasja dhe plani i auditimit);
- Afatin kohor dhe fazat e realizimit;
- Kërkesat për dokumentacion paraprak;
- Propozimin financiar (tarifat dhe kushtet e pagesës);
- Çdo informacion tjetër relevant.

Kushtet dhe rregullat e tenderit:

- Të gjitha ofertat të dërgohen të mbyllura në zarf në adresën e zyrës qendrore të AFK-së në Pejë: Rruga "Lidhja e Prizrenit" nr.20, ose përmes postës elektronike në prokurimi@afkonline.org.

Dispozita të përgjithshme:

- Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen;
- Të gjitha informacionet e shkëmbyera gjatë procesit trajtohen si konfidenciale.

Afati i fundit për pranimin e aplikimeve: 30.04.2026, ora 16:00.